# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-438001**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Nisja e sezonit shkollor, Hita për sigurinë në shkolla: Orë ndërgjegjësuese për rreziqet, do të bëjmë kontrolle të vazhdueshme |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/12/nisja-e-sezonit-shkollor-hita-per-sigurine-ne-shkolla-ore-ndergjegjesuese-per-rreziqet-do-te-bejme-kontrolle-te-vazhdueshme/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 12 shtator 2026, 09:04:52 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 12 shtator 2026, 09:00:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 12 shtator 2026, 08:59:00 UTC → 12 shtator 2026, 09:01:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `612f1ad7f3d53c1cb43dd7454952f5119d3eff127261ef44894b20fd6aa98ad3` |
| TEKSTI | `233bebc39007af65bc0150d6019608a4dfaf086cd4ac802db1d035cf7814a1fc` |
| PAMJA | `09e2c1b0690e21c38e274694a95f6d440619fcd4b3cbc783da1f681e8ee8a15e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `65bb9fa888025c3d2e26ce8bad483efaa57f986e697306b28ac8858aa892451c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `e9af2032378bf2027ef946e33134a1ef681b247480611ef66f9321bbe5be73d8` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/65bb9fa888025c3d2e26ce8bad483efaa57f986e697306b28ac8858aa892451c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET | TË FUNDIT

# Nisja e sezonit shkollor, Hita për sigurinë në shkolla: Orë ndërgjegjësuese për rreziqet, do të bëjmë kontrolle të vazhdueshme

12/09/2026 11:00




**Kreu i Policisë së Shtetit, Skënder Hita, ka folur rreth masave të marra, teksa jemi një ditë përpara nisjes së sezonit shkollor 2026-2027.**

Ai është ndalur tek masat e sigurisë, teksa po ashtu këtë herë do të bashkëpunojnë me AKU-në për ushqimet që do tu ofrohen fëmijëve.

*"Në krye të të gjitha shërbimeve të angazhuara për sigurinë në shkolla do të jenë shefat e komisariateve, të cilët do të kenë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për organizimin, koordinimin dhe kontrollin e shërbimeve në territor.*

*Kam kërkuar që këto masa të mos mbeten vetëm në planifikim, por të kontrollohen dhe të zbatohen në terren. Përgjegjësia është konkrete dhe do të jetë e qartë për çdo drejtues vendor të Policisë.*

*Në këtë kuadër, kam udhëzuar specialistët e sektorëve kundër Narkotikëve dhe atyre Operacionalë në të 12 drejtoritë vendore të Policisë, që të organizojnë kontrolle me intensitet të lartë, si brenda, ashtu edhe jashtë perimetrit të sigurisë, me fokus identifikimin dhe ndalimin, me forcën e ligjit, të çdo elementi kriminal që tenton t'u afrohet institucioneve arsimore, të bëjë nxënësit pjesë të veprimtarive kriminale, veçanërisht në fushën e narkotikëve, apo t'u shesë atyre sende të tjera të kundërligjshme dhe me pasoja për jetën dhe shëndetin.*

*Vëmendje të veçantë i kemi kushtuar edhe sigurisë rrugore pranë shkollave, për mbrojtjen e fëmijëve gjatë lëvizjes së tyre në fillim dhe në mbarim të orarit mësimor, si dhe gjatë pushimit të gjatë.*

*Rol të rëndësishëm në masat e ndërmarra nga Policia e Shtetit për garantimin e sigurisë dhe mbarëvajtjen e vitit të ri shkollor ka edhe ndërgjegjësimi.*

*Në këtë drejtim, strukturat e Policimit në Komunitet, të Dhunës në Familje, të Krimeve Kibernetike dhe të Policisë Rrugore do të jenë të pranishme në shkolla, me orë ndërgjegjësuese për rreziqet e bullizmit, dhunës psikologjike në shkolla dhe në hapësirën digjitale, për sigurinë rrugore, si dhe për reduktimin e përdorimit të drogës, duhanit dhe alkoolit.*

*Gjithashtu, në kuadër të paketës së sigurisë në shkolla, po bashkëpunohet intensivisht me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit për të garantuar sigurinë e produkteve ushqimore në të gjitha bizneset që operojnë pranë shkollave.*

*Do zhvillojmë kontrolle periodike në këto subjekte, për të verifikuar jo vetëm formalitetin e ushtrimit të aktivitetit të tyre ekonomik, por edhe përbërjen dhe skadencën e produkteve që konsumojnë nxënësit, si dhe kushtet higjieno-sanitare ku mbahen dhe*


## Kryesore




**Arratisje spektakolare në Greqi! Bashkëpunëtorët i bënë pritë me kallashnikov, zbulohet identiteti i të burgosurit shqiptar**
10:20

**"Veliaj në burg, absurd i kryeqytetit", Rama për hetimet ndaj Belinda Ballukut: Nuk e mbron askush, çështjen e ka me drejtësinë**
08:06

**Aksident i rëndë në Himarë, automjeti përmbyset në rrugë, tre persona të lënduar**
07:56

**Diferencë e ngushtë votash dhe reagime të forta jashtë Parlamentit, deputetët britanikë rrëzojnë projektligjin për vdekjen e asistuar**
07:00

**Inter, vjen ora e John Stones, gati të bëjë debutimin si titullar në sfidën ndaj Udineses**
09:24

## Më të lexuarat

**Detaje tronditëse nga vdekja e papritur e Mazonakis/ Pasi u 'ngeli në dorë', mjekët kërkonin në ChatGPT si ta rikthenin në jetë, i bënë edhe foto**

**"Ai i ka ikur drejtësisë, s'meriton replikë", Rama flet për Ahmetajn dhe akuzat ndaj tij: Kisha investuar në një maskë karnavalesh, jo në një aset publik për t'u besuar**

**"Veliaj në burg, absurd i kryeqytetit", Rama për hetimet ndaj Belinda Ballukut: Nuk e mbron askush, çështjen e ka me drejtësinë**

**Pas betimit si ministre, Spahiu ndan detyrat te Shëndetësia: Që nga nesër në orën 08:00 do hapet një zyrë për problemet e qytetarëve**

**Angazhimi në 'Praninë Besnike', deputetët Spiropali dhe Xhafaj edhe këtë të premte asnjë njoftim**

**Operacioni misterioz në Greqi, kush është trafikanti i kokainës që u arrestua dhe kërkohej nga Shqipëria për vrasje?**

**Erion Braçe i bashkohet "Pranisë Besnike", zbulon çfarë i kërkuan banorët e lagjes "më të varfër, por më fisnike" në Tiranë**

**Përgjimet e Ron Yefet dhe trafik armësh nga Afrika, ministrja Ismaili i përgjigjet denoncimeve të Ahmetajt: Më vjen ndot të komentoj deklaratat e të arratisurve nga drejtësia**

*tregtohen këto produkte.*

*Në këtë sipërmarrje, rol të rëndësishëm luajnë edhe oficerët e sigurisë në shkolla, mësuesit dhe psikologët. Ata janë ura jonë e drejtpërdrejtë e lidhjes me përditshmërinë në shkollë dhe një pikë e rëndësishme kontakti për evidentimin në kohë të problematikave.*

*Në kuadër të projektit Smart City, në 20 shkolla janë vendosur kamera inteligjente, të cilat rrisin kapacitetet tona për monitorimin dhe parandalimin e situatave që mund të cenojnë sigurinë.*

*Teknologjia na mundëson të jemi më të shpejtë në evidentimin e problematikave, më efikasë në reagim dhe më pranë qytetarëve, aty ku prania dhe ndërhyrja jonë kërkohet*", tha Hita.

**Top Channel**

## Aktualitet »



Operacioni antidrogë në Athinë, kreu i Policisë së Shtetit konfirmon: Mes shqiptarëve të arrestuar edhe një i kërkuar për vrasje në vendin tonë

12/09 10:59



FOTO/ Aksident në kryqëzimin e rrugës "Bardhyl", urbani i Linzës përplaset me një automjet

12/09 10:26



Arratisje spektakolare në Greqi! Bashkëpunëtorët i bënë pritë me kallashnikov, zbulohet identiteti i të burgosurit shqiptar

12/09 10:20



Shiu fik zjarret/ Përmirësohet situata në vend, vetëm një vatër vijon aktive. Shuhen flakët në Dajt dhe në Malin me Gropa

12/09 10:17



Aksident në fshatin Mazhar të Selenicës, automjeti del nga rruga dhe bie nga një lartësi të madhe, humb jetën shoferi

12/09 10:08



Rikthehen reshjet në verilindje, temperaturat bien me 10 gradë në Kukës

12/09 09:40

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »




Top News – Tajlandezët, protestë kundër izraelitëve. Tubimi para ambasadës- Respektoni kulturën tonë



Top Channel/ Krerët e UCK-së në Hagë, nis sot "Marshimi për Liri": Kurti nuk konfirmon pjesëmarrjen!



Top Channel/ Denoncimi në protestë: Shqiptarët po pengohen në Mal të Zi



Top Channel/ Rama i thotë të gjitha: Ahmetaj? Maskë karnavalesh! S'kam folur me Trump për...



Top Channel/ Humbja me Kukësin, Besëlidhja nis përgatitjet për fitore



Top Channel/ Historia drithëruese! Bëhet nënë nga embrioni i ngrirë 53-vjeçe

Përparimi i Huthëve në Jemen rrit rrezikun në Detin e Kuq, analistët paralajmërojnë: Fitimet territoriale mund të jenë të vështira për t'u përmbysur

Tërmet te Kosova, Rrahmani braktis Kombëtaren: Nuk kthehem sa kohë janë ata drejtues Federate




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.